# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446934**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | PE-ja kritikon ashpër Serbinë për Mlladiçin |
| ADRESA | `https://dosja.al/bota/pe-ja-kritikon-ashper-serbine-per-mlladicin-i514307` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 17:56:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 17:48:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1c5008643b10c372d4726b74153f3c9c90eba46a0bb476096dacb346c178fa3b` |
| TEKSTI | `aad98f2f781a99289e931f95b075bdd7e07fb7adc7602e603d8e7f2897ccc433` |
| PAMJA | `b02b53ecd5b24a492bc4adccfe65b7649d0176b97e8f2674615e5cd04d798b48` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a4be1cf6c779ad061f618cb124101b8306711ba76af607d58c6e0db19083a4e9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcfc62e639a2bd2cb31edd1709` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a4be1cf6c779ad061f618cb124101b8306711ba76af607d58c6e0db19083a4e9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

2 MINUTA ME PARE
**109 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Edi Rama jep dorëheqjen**

2 ORE ME PARE
**SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Po punojmë për shkatërruar organizatat kriminale. Kosovë- Serbi të shmangin provokimet**

4 ORE ME PARE
**Pagat e magjistratëve/ Seanca dëgjimore me institucionet e drejtësisë në komisionin e Ligjeve, KLP e GJL kundër formulës së PS: Rritje minimale**

8 ORE ME PARE
**Rekursi i Veliajt në Gjykatën e Lartë/ GJL lë fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Veliaj mbetet në burg**

Bota

# PE-ja kritikon ashpër Serbinë për Mlladiçin

Gjatë një debati të jashtëzakonshëm në Parlamentin Evropian, ajo përmendi veçanërisht pjesëmarrjen në varrim të ministrave të Qeverisë së Serbisë, si dhe të politikanëve nga Republika Sërpska, të cilët, sipas saj, “i bënë nderime një krimineli lufte”.

dosja
15 Shtator 2026, 19:48
**Nga G.M**



Komisionarja për Zgjerim, Marta Kos, gjatë një adresimi të mëhershëm në Parlamentin Evropian.

Komisionarja evropiane për Zgjerimin, Marta Kos, përsëriti qëndrimin se pamjet nga varrimi i Ratko Mlladiqit, i dënuar për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Bosnje e Hercegovinë, ishin tejet shqetësuese.

Gjatë një debati të jashtëzakonshëm në Parlamentin Evropian, ajo përmendi veçanërisht pjesëmarrjen në varrim të ministrave të Qeverisë së Serbisë, si dhe të politikanëve nga Republika Sërpska, të cilët, sipas saj, “i bënë nderime një krimineli lufte”.

*“Të jesh mik i Serbisë do të thotë të jesh i sinqertë me Serbinë. Mund të mos pajtohemi për politikën. Mund të zhvillojmë biseda të vështira për reformat dhe rrugën evropiane të Serbisë. Por, nuk mund të negociojmë për dinjitetin e viktimave të gjenocidit dhe krimeve të luftës”*, tha Kos gjatë debatit të jashtëzakonshëm në PE kushtuar varrimit të Ratko Mlladiqit dhe madhërimit të kriminelëve të luftës.

*“Evropa nuk do t’i kërkojë kurrë Serbisë të heqë dorë nga identiteti apo historia e saj. Por, Evropa do të kërkojë nga Serbia që të përballet sinqerisht me historinë e saj, përfshirë edhe kapitujt e saj më të errët”*, shtoi zyrtarja e lartë evropiane.

Në emër të Komisionit Evropian, Kos u bëri thirrje autoriteteve serbe, si dhe të gjithë aktorëve në rajon, që të kontribuojnë në pajtim dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Ajo bëri thirrje në veçanti që e kaluara të mos përdoret më si pengesë për të ardhmen.

Megjithatë, gjatë debatit, Kos tha se pamjet nga Beogradi në ditën e varrimit të Ratko Mlladiqit nuk e përfaqësojnë shoqërinë serbe në tërësi. Ajo tha se kishte marrë letra nga qytetarë të Serbisë që e kishin kundërshtuar madhërimin e kriminelëve të luftës.

*“Një Serbi e tillë meriton të dëgjohet, një Serbi e tillë meriton mbështetje dhe një Serbi e tillë e ka vendin e saj në*

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 19:26
FOTOLAJM/ Kosova ‘vishet’ me flamuj e portrete para aktgjykimit në Hagë: Çlirimtarë, sillni në shtëpi

POLITIKE 15 SHTATOR 2026, 18:15
Kongresmeni Wilson: Qeveria e Ramës po nxit trafikun e narkotikëve. Zv/ndihmës Sekretari Lawton: Organizatat kriminale kanë lidhje me kartelet këtu në SHBA

*Evropë*", tha Kos, duke shprehur gatishmërinë e Komisionit Evropian për ta ndihmuar Serbinë në rrugën e saj evropiane.

Gjatë debatit, Ivo Davor Shtir, deputet i Partisë Popullore Evropiane (EPP), grupimit më të madh politik në PE, ku Partia Përparimtare Serbe është anëtare e asociuar, tha se u takon qytetarëve të Serbisë të vendosin se çfarë vendi duan, por se pala evropiane duhet të vendosë se si do të sillet ndaj kësaj.

*"Nuk kemi iluzione se do të zgjohet ndërgjegjja e atyre që edhe në vitet '90 ishin pasivë, por pikërisht për këtë ne në Parlament duhet të jemi edhe më të zëshëm dhe të themi se politika e deritanishme e BE-së ka qenë e vakët dhe joefektive. Duhet të dërgojmë një mesazh të qartë dhe të vendosim se nuk ka vend në familjen evropiane për ata që madhërojnë Ratko Mlladiqin, dhe nuk duhet të ketë as para evropiane për ata që nuk duan të distancohen nga politika e Sllobodan Milloshevigit"*, tha ai.

Duke vlerësuar se qytetarët serbë kanë të drejtë në perspektivën evropiane dhe se askush nuk dëshiron që kjo perspektivë të "varroset për shkak të Mlladiqit", deputeti i EPP-së tha se ishte gabim i madh t'u mbyllej një sy atyre që e nderojnë Mlladiqin.

*"Viktimat e tij e kanë merituar solidaritetin tonë, por edhe që BE-ja të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm"*, theksoi Shtir.

Raportuesi për Serbinë në Parlamentin Evropian, deputeti Tonino Picula, tha se pjesëmarrja në ceremoninë e varrimit të një krimineli lufte nuk flet vetëm për qëndrimin krejtësisht të papranueshëm ndaj të kaluarës së afërt dhe tragjike, por edhe për drejtimin në të cilin pushteti po e orienton sot Serbinë.

*"[Presidenti i Serbisë, Aleksandar] Vuçiqi e përcolli një kriminel lufte me nderime shtetërore, ndërsa me një tjetër, [i dënuari nga Tribunali i Hagës, Vojsllav] Sheshelin, u dakordua për një koalicion parazgjedhor. Ne në Bashkimin Evropian luftojmë vazhdimisht kundër lajmeve të rreme dhe dezinformimit, por duhet të luftojmë edhe kundër revizionizmit historik dhe relativizimit të krimeve"*, tha Picula.

*"Nëse tashmë pushteti serb endet pa një drejtim të qartë, Bashkimi Evropian duhet të ketë qëndrim të qartë me një pushtet të tillë. Nuk duhet të izolohet nga faktet që qartësisht tregojnë se Serbia e Vuçiqit nuk e ka vendin në Bashkimin Evropian"*, shtoi ai.

Picula gjithashtu ngriti, siç tha, pyetjen e arsyeshme nëse Bashkimi Evropian duhet të vazhdojë fare negociatat me Serbinë përderisa ajo ka një pushtet të tillë.

Ish-komandanti i Ushtrisë së Republikës Sërspka, Ratko Mlladiq, të cilin Tribunali i Hagës e dënoi për gjenocid dhe krime të tjera lufte në Bosnje e Hercegovinë, u varros më 7 shtator në Beograd me nderime ushtarake dhe shtetërore. Mlladiqi vdiq në Hagë më 27 gusht, gjatë vuajtjes së dënimit me burgim të përjetshëm, dhe u varros në varrezat Topçider të Beogradit.

Përkujtimin, shërbesën fetare dhe varrimin në Beograd i shoqëruan paralajmërime nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për papranueshmërinë e madhërimit të kriminelëve të dënuar të luftës. Ai u varros me të nderime dhe fjalime lamtumire nga familjarët dhe ish-bashkëpunëtorët, në të cilat u madhërua e kaluara e tij e luftës.

Në prani të udhëheqjes politike të Republikës Sërpska dhe zyrtarëve të Serbisë, klerit të Kishës Ortodokse Serbe dhe pjesëtarëve të Ushtrisë së Serbisë, mijëra pjesëmarrës brohoritën emrin e Mlladiqit, duke e përcjellë arkivolin me duartrokitje dhe këngë. Pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qeverisë së Serbisë në varrim e dënoi udhëheqja më e lartë e BE-së, duke shprehur tronditje nga pamjet e Beogradit në ditën e varrimit./REL

marta kos | ratko mlladiç

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 13:44

Skema se si IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

## më të klikuarat

Pse bën foto? Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Dhunuan me grusht qytetarin gjatë arrestimit, Taulant Balla i del në mbrojtje Policisë: Bën detyrën e tyre

Vitin e ardhshëm zgjedhjet lokale/ Qeveria 'hap thesin' për pensionistët: Nga 1 janari do dyfishohet bonusi për të gjitha kategoritë

## insights

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi
REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

## Sondazh

Poll

## Moti

Powered by tomorrow.io

Bota

15 Shtator 2026, 18:16

# Kancelari gjerman Merz përballë krizës në CDU, kërkon mbështetje ose kërcënon me dorëheqje

Friedrich Merz GJERMANI- Kancelari gjerman Friedrich Merz po përballet me presion në rritje brenda Partisë Kristian Demokrate (CDU), pas rez...

---

### Trump sulmon gjyqtarët e Gjykatës Supreme që emëroi: Nuk janë njerëzit që zgjodha

Bota

15 Shtator 2026, 17:41

---

### Tarifat amerikane arrijnë në 50%, Kryeministri kanadez: Kanadaja do të mbetet partneri më i mirë i SHBA-së

Bota

15 Shtator 2026, 16:39

---

### Fermerët ndezin zjarre në protesta në Holandë, bllokohen autostradat dhe linjat hekurudhore

Bota

15 Shtator 2026, 16:19

---

### Lirohet nga burgu ish-zëdhënësi i 'Agimit të Artë', Ilias Kasidiaris paralajmëron rikthimin në politikë

Bota

15 Shtator 2026, 16:13

---

Bota

15 Shtator 2026, 15:21

# Dronët ukrainas shqetësojnë Kremlinin, Putin zhvendos forumin Valdai nga Soçi në Moskë

Presidenti rus Vladimir Putin RUSI- Presidenti rus Vladimir Putin ka vendosur të zhvendosë nga Soçi në Moskë forumin vjetor t&eu...

---

### Përdorën emrin e rrjetit 'Foxtrot' për të kryer vrasje në Britani, arrestohen tre të rinj në Norvegji

Bota

15 Shtator 2026, 14:55

---

### Fregata ruse qëllon me fishekzjarrë një helikopter ushtarak danez

Bota

15 Shtator 2026, 14:57

---

### Udhëtime luksoze me avionë privatë, nisin hetimet ndaj ish-ministrit të Jashtëm të Hungarisë

Bota

15 Shtator 2026, 14:45

---

### "Votat e tyre po bëhen gjithnjë e më vendimtare"/ Analiza: Pse partitë e konsoliduara në Gjermani po humbasin votuesit migrantë?

Bota

15 Shtator 2026, 14:38

**MË SHUMË**






Korreshi përplaset me Gogun për Sokol Sadushin, ministri: Nuk e ke kuptuar ende punën e një deputeti



"Paga bruto e një magjistari"/ Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste



"Paga bruto e një magjistari"/ Gafa e deputetes socialiste Aulona Bylykbashi



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.